



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.1.Regj.Them.

Nr.1.VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Kryesues seance*)

Gjyqtare: Edlira PETRI (*Anëtare*)

Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)

Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)

Gjyqtare: Emona MUÇI (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 16.10.2020, mbaroi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen zgjedhore me nr.1.akti që i përket:

Paditës: Tasim Mehmeti, i biri i Eminit, i datëlindjes 10.05.1956, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, rr. “Babë Rexha”, pallati nr.15, shkalla 2, hyrja 3, cel.(...), përfaqësuar edhe nga av. Shpëtim Kodhelaj (*me deklaram*).

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga juristët Olsi Peto dhe Erion Meta.

Objekti:

- 1) Pavlefshmërinë absolute të Aktit Administrativ (shkresës kthim-përgjigje) nr.174/1.prot, datë: 21.02.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 2) Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për paditësin Tasim Mehmeti.
- 3) Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të shprehet me vendim.

Baza Ligjore: Nenet 153, 152/1, 145/2 të ligjit nr.10019, datë: 29.12.2008 dhe nenet 1, 64/1, 64/2, 64/3, 68/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 108/b, 116/c të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

Se paditësi Tasim Mehmeti i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 26.02.2020, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të Aktit Administrativ (shkresës kthim-përgjigje) nr.171/1.prot, datë: 21.02.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë për paditësin Tasim Mehmeti, detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të shprehet me vendim. Kjo kërkesëpadi nuk u shqyrtua në kohë nga Kolegji i mëparshëm Zgjedhor, për shkak të mosformimit të trupit gjykues dhe pas mbarimit të mandatit të gjyqtarëve të atij Kolegji, çështja u transferua për shqyrtim nga Gjykata e Apelit Tiranë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, pranë të cilës e ushtron tashmë veprimtarinë Kolegji i ri Zgjedhor Gjyqësor.

I. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Paditësi Tasim Mehmeti ka qenë kandidat për deputet në qarkun Vlorë, në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, të mbajtura në vitin 2017, duke garuar për subjektin zgjedhor “Sfida për Shqipërinë”. Ky fakt provohet nga vërtetimi nr.5501/1.prot, datë: 13.09.2017 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe vendimi datë 05.05.2017 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e listave shumëemërore të partisë Sfida për Shqipërinë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”. Paditësi rezultoi i dyti në listën e kandidatëve për deputet në qarkun Vlorë.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e tij të datës 26.07.2017 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017, nga ku ka rezultuar se subjekti “Sfida për Shqipërinë”, në Qarkun Vlorë ka marrë gjithësej 143 vota, ose 0.13% të totalit të votave, duke mos marrë ndonjë deputet.

3. Më datë 11.02.2020 paditësi Tasim Mehmeti i është drejtuar me kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku ka kërkuar të marrë një mandat deputeti në Kuvendin e Shqipërisë. Arsyeja për këtë lidhet me faktin se sipas tij Kuvendi, si pasojë e vendeve vakante, ka mangësi në

numrat si deputet, pasi nuk plotësohet numri 140 i deputetëve. Sipas paditësit nëse i jepej mandati, kjo do t'i shërbente parlamentarizmit, demokracisë funksionale për shtetin ligjor dhe funksional. Me shkresën nr.174/1.prot, datë: 21.02.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar paditësin Tasim Mehmeti se subjekti politik "Sfida për Shqipërinë" nuk ka asnjë mandat deputeti. Ndaj këtij vendimi paditësi ka paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor padinë objekt gjykimi.

4. Në parashtrimet e paditësit në seancë gjyqësore ai parashtroi se i qëndron kërkimeve në padinë e tij. Sipas paditësit KQZ nuk ka respektuar dispozitat ligjore për përmbajtjen e vendimeve që duhet të marrë. KQZ nuk ka dhënë asnjë shpjegim se përse nuk i ka dhënë mandatin e deputetit kërkuarit Tasim Mehmeti dhe ku është e bazuar ajo. KQZ nuk ka zbatuar nenin 144 të Kodit Zgjedhor dhe ka shkelur procedurën administrative që i mundësonte kërkuarit të ngrinte pretendime dhe shpjegime. Paditësi nuk është dëgjuar nga KQZ. Është detyrim kushtetues për KQZ që të plotësojë vendet vakante në Kuvendin e Shqipërisë. Largimi i opozitës nga parlamenti nuk do të thotë që KQZ të qëndrojë pasive, pa vepruar dhe analizuar faktet provuese, pasi ajo ka detyrimin të plotësojë vendet vakante në Kuvend. Parlamenti i Shqipërisë nga ana formale ka 140 deputetë e ka mangësi pasi mungon formalisht kuorumi i përgjithshëm.

5. I padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prapësoi se paditësi nuk legjitimohet t'i drejtohet KQZ dhe Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padi, pasi ai nuk është subjekt zgjedhor në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe për më tepër nuk është as i autorizuar nga kryetari i partisë Sfida për Shqipërinë. Paditësi nuk ka asnjë bazë ligjore për të kërkuar mandat deputeti dhe nuk ka ndjekur kërkesat e neneve 124 dhe 164 të Kodit Zgjedhor.

II. LIGJI I ZBATUESHËM

6. Neni 2(20) i Kodit të Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (siç ka qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë) parashikon se:

"20. "Subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod."

7. Neni 63(1)(2) i Kodit Zgjedhor parashikon se:

"1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod."

2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod."

8. Neni 145 i Kodit Zgjedhor parashikonte se:

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.”

9. Neni 158 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

- a) pushimin e gjykimit;
- b) gjykimin e çështjes në themel; ose
- c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.

3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.

4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.

5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

6. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij.”

10. Neni 164 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij Kodi, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.

2. Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

3. KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të regjistruar sipas nenit 67 të këtij Kodi. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përlygjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 1 ose 2 të këtij neni. E njëjta procedurë vazhdon deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike.

4. Në rast kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë. Kur mandati i ndërprerë i përket një kandidati të propozuar nga zgjedhësit, mandati i kalon subjektit zgjedhor me herësin më të lartë. Kur mandati i takon një koalicioni zgjedhor, ai i shpërndahet partisë pjesëtare të koalicionit me herësin më të lartë.”

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

11. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se padia e paraqitur nga paditësi Tasim Mehmeti është e pabazuar në ligj e në prova dhe për këtë shkak duhet rrëzuar.

12. Paditësi Tasim Mehmeti ka qenë një nga kandidatët (i dyti në listë) për deputet në qarkun e Vlorës, të partisë “Sfida për Shqipërinë”, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017. Subjekt zgjedhor në këtë rast, në kuptim të neneve 2(20) dhe 63(1)(2) të Kodit Zgjedhor është partia “Sfida për Shqipërinë” dhe jo kandidati i kësaj partie Tasim Mehmeti. Si i tillë paditësi, në cilësinë e tij si individ nuk gëzon legjitimim aktiv për të vënë në lëvizje KQZ-në me kërkesë apo Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi. Rrjedhimisht, duke mos qenë subjekt zgjedhor, apo subjekt tjetër që legjitimohet të vërë në lëvizje KQZ-në, kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkresën nr.174/1.prot, datë: 21.02.2020, duke e informuar se subjekti politik “Sfida për Shqipërinë” nuk ka asnjë mandat deputeti.

13. Në kushtet kur paditësi Tasim Mehmeti nuk legjitimohej aktivisht pasi nuk ishte subjekt zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kishte detyrimin të shprehej me vendim për kërkesën e paditësit për të marrë një mandat deputeti në Kuvendin e Shqipërisë. Ky përfundim arrihet nëse shihet edhe neni 164 i Kodit Zgjedhor, në lidhje me specifikën konkrete të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Konkretisht, neni 164 i Kodit Zgjedhor e ka rregulluar qartë procedurën që ndiqet në rastet e ndërprerjes së mandatit dhe

zëvendësimit të vakancës në Kuvendin e Shqipërisë. Sipas kësaj dispozite “[m]andati i ndërprerë i deputetit [...] i kalon kandidatit vijues të listës së **të njëjtës parti politike** në zonën zgjedhore përkatëse. [...]” dhe për rrjedhojë subjekti zgjedhor “Sfida për Shqipërinë” (nëse do të ishte ajo kërkuese ose paditëse), duke mos pasur mandat deputeti të fituar në zgjedhje, nuk mund të kërkonte zëvendësimin me kandidatët e saj të vakancës së deputetëve të partive të tjera. Këtë të drejtë nuk e ka as paditësi Tasim Mehmeti. Kjo pasi ligji parashikon se plotësimi i vakancave vijon me kandidatët e së njëjtës parti që kishte mandatin e deputetit që u bë vakant, deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike. Më tej, neni 164(4) i Kodit Zgjedhor parashikon shprehimisht se “[n]jë rast kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë. Kur mandati i ndërprerë i përket një kandidati të propozuar nga zgjedhësit, mandati i kalon subjektit zgjedhor me herësin më të lartë. Kur mandati i takon një koalicioni zgjedhor, ai i shpërndahet partisë pjesëtare të koalicionit me herësin më të lartë”. Në rastin konkret objekt gjykimi kjo do të thotë se, subjektet zgjedhore që janë paraqitur në zgjedhje të vetme dhe nuk kanë marrë ndonjë mandat deputeti, ose kanë qenë pjesë e një koalicioni dhe ky i fundit nuk ka fituar ndonjë mandat deputeti, nuk mund të plotësojnë vakancat e krijuara në Kuvend nga partitë politike ose koalicionet që kishin fituar mandate, të cilat më pas u bënë vakante.

14. Lidhur me sa më sipër gjykata vëren se, përveç faktit që paditësi Tasim Mehmeti nuk legjitimohet të paraqesë kërkesë për mandat deputeti në KQZ dhe më pas padi në Kolegjin Zgjedhor, pretendimet e tij janë edhe në themel të pabazuara. Kjo pasi, paditësi ka kandiduar për një subjekt zgjedhor që nuk ka qenë pjesë e ndonjë koalicioni parazgjedhor që ka marrë deputetë në zgjedhje, por ka garuar i vetëm dhe si i tillë nuk ka fituar ndonjë mandat deputeti në zgjedhjet e vitit 2017 për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Për këtë shkak nuk mund të pretendohet marrja e mandatit të deputetit, pasi kjo e drejtë i përket vetëm kandidatëve në listat e partive që kanë fituar deputetë në zgjedhje, apo që kanë qenë pjesë e një koalicioni që ka fituar mandate. Gjykata thekson se asnjë person nuk mund të fitojë mandat deputeti jashtë rregullave të paracaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor. Përfaqësimi i popullit nga deputetët lidhet në çdo rast me votën e dhënë nga zgjedhësit për ta, e cila është përkthyer në mandat deputeti, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

15. Përfundimisht, padia e paditësit Tasim Mehmeti është e pabazuar në ligj e në prova jo vetëm se ai nuk legjitimohet individualisht (pasi nuk është subjekt zgjedhor) të vërë në lëvizje Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, por edhe sepse në themel pretendimet e tij janë të pabazuara. Duke qenë një nga kandidatët për deputet në qarkun Vlorë të partisë “Sfida për Shqipërinë”, e cila bazuar në votat e zgjedhësve nuk ka marrë mandate deputeti dhe njëkohësisht nuk ka

qenë pjesë e ndonjë koalicioni që ka fituar mandate, atëherë në kuptim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, paditësi Tasim Mehmeti nuk mund të pretendojë ndonjë të drejtë për të fituar mandat deputeti në Kuvendin e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e padisë së paditësit Tasim Mehmeti.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë: 16.10.2020.

ANËTARE

Manjola XHAXHO

ANËTARE

Edlira PETRI

KRYESUES

Asim VOKSHI

ANËTARE

Emona MUÇI

ANËTARE

Alma KOLGJOKA